



Kom.Dh.Shk.II.nr.1045/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkalles se Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj – Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - konfliktin administrativ sipas propozuesit – paditësit Kompania N.SH. “Kastrioti” me seli ne Obiliq me NRB 810386624, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Sallova avokat nga Prishtina, kundër kundërshtares se propozimit - të paditurës Komuna e Obiliqit – Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, me bazë juridike për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, datë 15.12.2023, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit - propozuesit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Departamenti për çështje administrative KA.nr.57/24, të datës 29.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditësit-propozuesit Kompania N.SH. “Kastrioti” me seli ne Obiliq, ndërsa Anullohet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Departamenti për çështje administrative KA.nr.57/24, të datës 29.01.2024 dhe lënda i kthehet në Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për çështje administrative, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Departamenti për çështje administrative KA.nr.57/24, të datës 29.01.2024, është refuzuar propozimi i paditësit – propozuesit paditësit Kompania N.SH. “Kastrioti” me seli ne Obiliq, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, datë 15.12.2023, të Komuna e Obiliqit – Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata në procedurën e konfliktit administrativ si e pabazuar.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Departamenti për çështje administrative KA.nr.57/24, të datës 29.01.2024 ka ushtruar ankesë i autorizuari paditëses – propozueses Kompania N.SH. “Kastrioti” me seli ne Obiliq me NRB 810386624, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Sallova avokat nga Prishtina,

për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së, me propozim që Gjykata e Shkallës së dytë ta prish aktvendimin e goditur me ankesë dhe lëndën t'ia kthejë Gjykatës së Shkallës së parë për rivendosje.

Kolegji i Gjykatës Komerciale e Kosoves - Dhoma e shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së propozueses/paditëses, kolegji i kësaj gjykate gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditëses për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit datë 15.12.2023 ka gjetur se propozimi i tillë është i pabazuar, ngase paditësja - propozuesja nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë të vetme pretendimin e tij, se me ekzekutimin e vendimit të paditurit, i njëjti do ti sillte dëm i cili vështirë do të riparohet dhe se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm të riparueshëm palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kusht ky ligjor i cili duhet të provohet nga paditësi, për të shtyrë pastaj gjykata ekzekutimin e vendimit të kontestuar. Andaj, gjykata gjatë vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, iu ka referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Sipas kolegjit të kësaj gjykate, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, nuk mund ti përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: “në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”.

Kolegji i kësaj gjykate vëren se, në rastin konkretë paditësi me propozim ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues të datës 15.12.2023 të lëshuar nga e paditura – kunderpropozuesja, ndërsa gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar kërkesën e propozueses për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të cituar më lartë, pa e vlerësuar fare vendimin datës 15.12.2023 të paditurës, dhe pa elaboruar asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e propozuesit, mirëpo është mjaftuar

vetëm me përshkrim të dispozitave ligjore, pa arsyetuar se pse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, dhe në këtë mënyrë ka vendosur që ta refuzoj kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit.

Mirepo, gjykata e shkallës së dytë, konstaton se gjykata e shkallës së parë, fillimisht nuk e ka vërtetuar faktin se vendimi i atakuar, a është akt përfundimtar administrativ, a i ka plotësuar kushtet për përpilimin e aktit, nga vendimi i atakuar nuk e qarte se për cilin vendim të organit kemi të bëjmë (pasi që si pala propozuese në petitutim ashtu edhe gjykata në dispozitiv të vendimit të atakuar) i referohen vetëm datës së marrjes së vendimit, pa e pasur qarte se për (pasi që nuk shenjë) cilin vendim është kërkuar mbrojtje gjyqësore, si dhe të arsyetoj mënyrën e vendosjes.

Dispozitivi i aktvendimit të ankimuar, sipas kësaj gjykate është i mangët dhe mos vlerësimi i fakteve vendimtare, siç, shihet qartë edhe nga arsyetimi i këtij aktvendimi, e të cilat nuk kanë mundur të arsyetohen fare, e që e gjithë kjo bie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, nuk ka mundur ti vlerësoj fare faktet e paraqitura në propozim e duke e bërë këtë gjithashtu nuk e ka pasur mundësin të vërtetoj gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, siç e parasheh dispozita e nenit 183 e LPK-së, e aplikueshme sipas nenit 63 të LKA.

Pas vlerësimit të propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të paraqitura, dhe pas përmbushjes së obligimit ligjor konform dispozitës së cekur më lartë, gjykata në bazë të provave të paraqitura duhet të vlerësojë kërkesën lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, dhe të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Për shkak të shkeljeve esenciale dhe qëndrimit të gabuar juridik gjykata e shkallës së parë, ka lëshuar të vërtetoi faktet qenësore për zbatimin e dispozitës së nenit 22 par.2 dhe 6 të LKA-së, për çka ankesa është dashtë që të aprovohet e të prishet aktvendimi dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedurë të mëtejme.

Nga sa u tha më lart e në bazë të nenit 43 par.2 dhe nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 209 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1045/2024 datë 24.05.2024

Kryetari i kolegjit
Faton Bajrami